



Në bazë të Nenit 9, alineja 1.1. dhe alineja 1.9. të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës më 22.09.2025, miraton këtë:

UDHËZUES PËR SHITJEN E BILETAVE ONLINE

Përkufizime

Për qëllimet e këtij udhëzuesi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- **Biletë digjitale** – biletë elektronike e pajisur me kod unik QR.
- **Platforma e Shitjes Online "KickTick"** – platforma e autorizuar nga FBK për shërbimin e shitjes së biletave online.
- **Event** – çdo ndeshje ose aktivitet i organizuar ose i mbështetur nga FBK.
- **Klubi organizator** – klubi që luan si vendas dhe menaxhon ndeshjen/eventin.

1. Qëllimi dhe fushëveprimi

Ky udhëzues përcakton procedurat, standardet dhe përgjegjësitë për implementimin dhe menaxhimin e sistemit të shitjes së biletave online nga FBK duke filluar nga edicioni garues 2025/26. Ai zbatohet për të gjitha eventet e FBK-së, përfshirë:

- **Ndeshjet e ProCredit Superligës;**
- **Superkupën e Kosovës;**
- **Kupën e Kosovës;**
- **Ndeshjet e Përfaqësuesëve të Kosovës;**
- **Eventet e tjera të organizuara ose të mbështetura nga FBK.**

2. Platforma e shitjes së biletave

2.1. KickTick do të ofroj shërbimin e shitjes së biletave online (elektronike) si Partner Ekskluziv i FBK dhe Klubeve për këto shërbime të listuara më poshtë:

- **Bileta digjitale** me kod QR për hyrje të shpejtë;
- **Zgjedhja e ulëses** në evente me ulëse të caktuara;



- **Pagesa të sigurta online** (kartela bankare, mobile wallet, etj.);
- **Analiza dhe raporte në kohë reale** për shitjet dhe hyrjet;
- **Promovim dhe marketing i eventeve** përmes kanaleve digjitale;
- **Integrim me sistemet e kontrollit të hyrjes** në palestra.

3. Procesi i shitjes së biletave online

3.1. Përgatitja e eventit

- Përcaktimi i informatave si data, ora, lokacioni, kategoritë dhe çmimet e biletave, do të vendosen mes FBK dhe Klubeve Vendase të Eventit.
- Koordinator i për Shitje të Biletave nga FBK do të jetë pika komunikuese mes KickTick dhe Klubeve.
- KickTick do të organizoj informatat në platformë dhe do të dorëzoj link-un e Eventit dhe qasjen në platformë.

3.2. Afatet kohore

- Afati minimal i hapjes së shitjes: minimumi 7 ditë para eventit, ose sipas vendimit të FBK-së.
- Afati për mbylljen e shitjes online: një orë para hapjes së eventit.
- Afati për raportimin financiar: brenda 3 ditëve pas përfundimit të eventit.
- Afati për dorëzimin e informatave të eventit: FBK dhe Klubet Vendase kanë kohë deri në 48 orë para eventit për të dorëzuar informatat finale apo ndryshime për një event në platformë.

3.3. Procedura e blerjes:

1. Vizitohet faqja e eventit;
2. Zgjidhet bileta;
3. Vendosen informatat e blerësit dhe mbajtësit të biletës;
4. Kryhet pagesa online;
5. Bileta i dërgohet në email blerësit të biletës sipas detajeve të ofruara gjatë blerjes;
6. Bileta e pranuar në email skanohet nga ekipi i Klubit Vendas dhe i lejohet hyrja në sallën e eventit.



4. Dispozita rreth kategorive të biletave

4.1. Biletat Vjetore

- Për sezonin 2025/26 të ProCredit Superligës, biletat vjetore do të vazhdojnë të jenë në formë fizike, shitja dhe menaxhimi i të cilave kryhet nga klubi.
- Duke filluar nga sezoni 2026/27, biletat vjetore do të digjitalizohen, pra do të shiten dhe menaxhohen gjithashtu përmes platformës KickTick.
- Për sezonin 2025/26, KickTick nuk do të mbajë përgjegjësi mbi biletat vjetore ekzistuese, dhe validimi i tyre do të kryhet manualisht nga klubet.

4.2. Biletat pa Pagesë

- Biletat pa pagesë ndahen në dy kategori:
 - Grupet e fansave zyrtar/tifozeritë e ekipeve;
 - Do të sigurohet kod promocional i dedikuar për çdo ndeshje;
 - Këto kode lejojnë blerjen manuale të biletës nga fansat, të cilët vendosin të dhënat e tyre personale, por pa kryer pagesë;
 - Kjo procedurë siguron regjistrimin e saktë të pjesëmarrësve dhe kontroll mbi numrin e ulëseve;
 - Kodi promocional mundëson blerjen e vetëm një (1) bilete për person, në mënyrë që të evitohet grumbullimi i shumë ulëseve nga një individ;
 - Biletat vlejnë vetëm për zonën e dedikuar të fansave.
 - Të ftuarit special/mysafirë të klubeve dhe FBK-së.
 - Klubeve dhe FBK-së u ofrohet një kod promocional me numër të kufizuar përdorimesh;
 - Pasi përdoret kodi, të dhënat e të ftuarit regjistrohen në platformë dhe bileta dërgohet automatikisht përmes email-it;
 - Procedura e njëjtë zbatohet edhe për sponsorët, me mundësinë e personalizimit të biletës në emër të kompanisë.



5. Standardet Teknike

Platforma e shitjes së biletave duhet të përmbushë këto standarde teknike:

- Pajtueshmëri me ligjet për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Kosovës dhe me standardet e përgjithshme të GDPR-së;
- Integrim të plotë me sistemet ekzistuese të kontrollit të hyrjes të FBK-së;
- Disponueshmëri të shërbimit (uptime) jo më pak se 99%;
- Të ofrohet siguria në procesin e blerjes së biletës nga ana e klientëve;
- Qasje të plotë për FBK në raportet dhe analizat në kohë reale.

6. Protokollet e emergjencës

Në rast të situatave të jashtëzakonshme, përfshirë por jo të kufizuara në anulim, shtyrje ose ndërprerje të eventit, do të zbatohen këto procedura:

- **Njoftimi i menjëhershëm** – FBK, në bashkëpunim me klubin organizator dhe KickTick, publikon njoftimin për publikun përmes kanaleve zyrtare (faqja e internetit, rrjete sociale, media).
- **Opsionet për biletat** – Të gjithë mbajtësit e biletave kanë të drejtë të:
 - **Rimbursimit të plotë apo të pjesshëm** të shumës së paguar (Kostot e transaksionit të rimbursimit do të mbulohen nga Klubi Vendas), ose
 - **Rizhvlërësimit të biletës** për një event tjetër të përcaktuar nga FBK, i cili mund të bëhet vetëm nëse event i zhvillohet në sallën e njëjtë.
- **Afatet e rimbursimit** – Procesi i rimbursimit do të nisë brenda 5 ditëve pune nga njoftimi zyrtar dhe do të përfundojë jo më vonë se 30 ditë kalendarike.
- **Metodat e rimbursimit** – Pagesat do të bëhen përmes së njëjtës metode që është përdorur për blerjen e biletës, përveç rasteve kur blerësi bie dakord për një metodë tjetër.
- **Dokumentimi** – KickTick dhe FBK do të mbajnë regjistrim të plotë të të gjitha rimbursimeve dhe rizhvlërësimeve, për auditim të mundshëm nga Bordi i FBK-së.



7. Roli dhe përgjegjësitë

7.1. FBK

- Përcakton standardet teknike dhe procedurat;
- Siguron koordinimin me klubet dhe KickTick;
- Monitoron shitjet dhe sigurinë e të dhënave;
- Raporton të ardhurat sipas rregullave financiare të FBK-së.

7.2. Klubet organizatore

- Japin informacion të saktë mbi kapacitetin dhe vendosjen e ulëseve;
- Sigurojnë infrastrukturën për kontrollin e biletave (skanerë, staf);
- Bashkëpunojnë për marketingun e eventit.
- Në rastin e ndryshimeve eventuale në strukturat e palestrave/sallave apo edhe hapësirave të eventeve, KickTick dhe FBK duhet të njoftohen në një afat kohor sa më të shkurtër në mënyrë që të merren të gjithë hapat e nevojshëm për të aplikuar ndryshimet në platformë.

7.3. KickTick

- Menaxhon platformën teknike;
- Ofron mbështetje teknike dhe raportim analitik;
- Ofron monitorimin e informatave dhe sigurinë e procesit të pagesës.

8. Menaxhimi financiar

FBK bën shpërndarjen e të hyrave nga shitja e biletave tek Klubet, ndërsa KickTick do të kompensohet në baza mujore sipas përqindjes së dakorduar me FBK-në. Raportet financiare mujore dhe individuale shpërndahen me FBK-në dhe Klubet.

9. Siguria dhe mbrojtja e të dhënave

Të gjitha transaksionet kryhen në mënyrë të sigurt (SSL encryption) dhe respektohen standardet e privatësisë dhe ligjet për mbrojtjen e të dhënave. Verifikimi i biletave në hyrje eliminon rrezikun e falsifikimit.

10. Marketingu dhe promovimi

10.1. FBK dhe Klubet do të përdorin kanalet zyrtare (rrjete sociale, email marketing, media) për të promovuar platformën dhe linkun e shitjes së biletave online.



10.2. KickTick mund të zhvillojë fushata promovuese të targetuara për të rritur shitjet.

10.3. Bashkë-promovimi i eventeve brenda platformës shfrytëzohet për të tërhequr audiencë të re.

11. Raportimi dhe analiza

Pas çdo event, KickTick ofron raporte të detajuara për:

- Numrin e biletave të shitura;
- Të ardhurat totale;
- Orarin e blerjeve;
- Profilin e blerësve (pa shkelur ligjin për privatësinë).

12. Zbatimi dhe kontrolli

FBK ka të drejtë të auditojë procesin e shitjes dhe raportimit.

Shkeljet e procedurave nga klubet mund të rezultojnë në gjoba ose masa të tjera disiplinore sipas rregulloreve të FBK-së.

Mekanizmi i monitorimit

FBK do të emërojë një **Koordinator për Shitjen e Biletave**, i cili do të ketë përgjegjësinë të ndjekë dhe të monitorojë procesin e shitjes së biletave për çdo event. Ky koordinator:

- Do të jetë pika e kontaktit midis FBK-së, klubeve organizatore dhe platformës KickTick;
- Do të verifikojë që procedurat dhe standardet e përcaktuara në këtë udhëzues të respektohen në të gjitha fazat;
- Do të raportojë drejtpërdrejt tek **Sekretari i Përgjithshëm i FBK-së** pas përfundimit të çdo event;
- Do të mbajë dokumentim të plotë për auditim dhe vlerësim nga Bordi i FBK-së.

13. Aneksi Teknik - Udhëzues për Shitjen e Biletave Online

13.1. Aneksi Teknik është pjesë përbërëse e këtij Udhëzuesi dhe ka për qëllim të ofrojë udhëzime praktike për përdorimin e platformës së shitjes së biletave. Ai përditësohet nga FBK në bashkëpunim me KickTick sipas nevojës.



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

13.2. Përmbajtja e aneksit:

1. **Shembull i raportit të shitjes** - Raport standard me të dhëna të shitjeve, të ardhurave dhe numrit të hyrjeve.
2. **Pamje nga platforma KickTick** - Ilustrime të faqeve kryesore për blerjen e biletës dhe për zgjedhjen e ulësës.
3. **Hapat për përdorimin nga klubet** - Udhëzim hap-pas-hapi për mënyrën se si klubet organizatore publikojnë eventin, menaxhojnë shitjet dhe shkarkojnë raportet.

Miraturar në Prishtinë, më 22.09.2025

Kryetar

Arben **FETAHU**

Federata e Basketbollit të Kosovës




Aneksi Teknik

Ky Aneks është i përgaditur nga KickTick për Klubet dhe Federatën e Basketbollit të Kosovës.

1. Raporti i Shitjeve

Për çdo event në platformën KickTick, Klubet Vendase dhe FBK do të kenë qasje në sistem për të shikuar informatat në kohë reale si më poshtë:

- Numri i Biletave të Shitura
- Të Hyrat Totale në Shitja e Biletave
- Emri, Mbiemri, Email Adresa e Blerësve



Të gjitha klubet do të kenë llogarinë e tyre në sistem, ku do t'i shfaqen informatat vetëm Klubit Vendas dhe FBK-së.


Në anën e majtë është navigimi mes faqeve, ku gjithsej janë 3 faqe:

- **Dashboard:** Informatat gjenerale rreth eventeve.
- **Events:** Eventet e regjistruara në platforma për atë llogari.
- **Orders:** Shitjet prej eventeve.


Në Dashboard gjinden informatat:

- Numri Total i Biletave të Shitura
- Eventet Aktive
- Të Hyrat e Këtij Muaji

Poshtë gjithashtu mund të gjeni një graf të biletave të shitura dhe të të hyrave sipas ditëve.



Në faqën e dytë janë Eventet aktive të regjistruara për atë llogari. Përmes butonit “Manage Event”, mund të hapen detajet e shitjeve për atë event specifik.




Tek faqja e tretë mund të gjeni të gjitha porositë, porositë e përfunduara (që ju ka përfunduar pagesa), porositë që janë duke u procesuar, dhe të hyrat.


Kjo faqe është e pajisur me filtera të ndryshëm si datat, eventet, llojet e biletave, dhe statuset e shitjeve.

Gjithashtu të gjitha këto informata mund të eksportohen në PDF.

Platforma KickTick




Kjo është faqja bazë e KickTick dhe në këtë pjesë do të listohen të gjitha eventet në platformën KickTick sipas datës më së afërt.




Platforma ka funksionin (filterin) e zgjedhjes së datave të preferuara për të shikuar eventet që janë vetëm në ato data.

Zgjedhja Ulëseve




Secila sallë do të jetë e personalizuar sipas strukturës reale të sallë. Ulëset do të kenë 3 ngjyra:


- **E Kuqe:** Ulëse e blerë
- **E Gjelbërt:** Ulëse e lirë
- **Ngjyrë Gri:** Ulëse e Rezervuar



Duke klikuar një ulëse të lirë, hapen informatat e ulëses së klikuar, blerësi klikon “Add to Cart”, për ta shtuar biletën në shportë.



Pastaj ulësja shtohet në shportë, informatat e shportës janë në anën e majtë por mund të shfaqen duke klikuar edhe në butonin “View Cart”.



Blerësi shikon shportën dhe mund të vazhdoj me blerjen.

E rëndësishme: Blerësi ka 15 minuta kohë për ta kryer blerjen e biletës nga momenti i rezervimit të ulësës në mënyrë që nëse nuk bëhet blerja, një person tjetër të ketë mundësi ta blejë atë.



Cart > Information > Payment

Information

Welcome back, **Gjin Zhuri** (gjinzhuri0@gmail.com).

Billing address

First name *	Last name *
Gjin	Zhuri
Street address	
Adresa	
Apartment, suite, unit, etc. (optional)	
Opcionale	
Country / Region *	
Kosovo	
Town / City	
Qyteti	
Phone (optional)	
Opcionale	

☐ I would like to receive exclusive emails with discounts and product information

[« Return to cart](#)

[Continue to payment](#)

Copyright © 2025, KickTick. All rights reserved.
[Music](#) [Sports](#) [Culture](#) [Growth](#) [All Events](#)

Enter Promo Code

[Apply](#)

Subtotal	3,00 €
Total	3,00 €

Këtë blerësi vendos informatat e blerjes.



Cart > Information > Payment

Contact gjinzhuri0@gmail.com

Payment

All transactions are secure and encrypted.



Pay by card easily and quickly

Tribuna A

1. Attendee Info (CC1)

First Name *
Last Name *
E-Mail *

Your personal data will be used to process your order, support your experience throughout this website, and for other purposes described in our [privacy policy](#).

Enter Promo Code

[Apply](#)

Subtotal	3,00 €
Total	3,00 €

Pastaj në hapin e radhës, vendosen informatat e biletës që përfshijnë emrin, mbiemrin dhe email-in ku do të pranohet bileta.

Dhe në fund është butoni për të vazhduar me pagesën. Ai buton i dërgon blerësit në faqën e bankës përkatëse për të përfunduar pagesën.

Pas përfundimit të pagesës, nëse është e suksesshme, blerësi kthehet automatikisht në KickTick dhe sheh një mesazh suksesi. Nëse nuk është e suksesshme, blerësi do të sugjerohet të provoj përsëri ose do t'i komunikohet arsyeja e problemit.

Skanimi i Biletave

Skanimi i biletave do të bëhet nga ekipi i Klubit Vendas. Mënyra se si do të strukturohet kjo është që për çdo event, KickTick do t'i mbledhë shifrat e biletave të cilat do të lexohen/validohen nga aplikacioni i KickTick.

Në mënyrë që kjo të jetë sa më efikase, mbyllja e shitjes së biletave do të bëhet të paktën 1 orë para ndeshjes. Pas mbylljes së shitjes, i dërgohet lista e shifrave të biletave të blera. Ato shifra vendosen në mënyrë automatike në aplikacionin e KickTick dhe mund të validohen biletat.

KickTick do të siguroj të gjitha shifrat e biletave të cilat do të dërgohen tek Kordinatori i Shitjes së Biletave të FBK-së, por është obligim i personit të autorizuar të Klubit Vendas për t'i vendosur ato shifra në aplikacionin përkatës.

KickTick përmes Kordinatorit për Shitje të Biletave do të trajnoj Klubet për këtë procedurë.